



REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:035053
Datë: 29.01.2025
Numri i dokumentit: 06771291

KA.nr.1158/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “QTA” SH.P.K, me seli në Mitrovicë, me përfaqësuesen e autorizuar Blerta Shyqeriu avokate kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr.Auv.Ref.04/2-52 i datës 23.12.2021, jashtë seancës, me datë 29.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit “QTA” SH.P.K, me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit nr.auv.ref.04/2-52 i datës 23.12.2021
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “QTA” SH.P.K, me seli në Mitrovicë me datën 18.02.2022 ka parashtruar padi, kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit Nr.Auv.Ref.04/2-52 i datës 23.12.2021.

Gjykata me datë 11.11.2024 paditësit i ka dërguar vërejtjen për pagesë të taksës, më të cilën e ka ftuar paditësin “QTA” SH.P.K, që brenda afatit prej 15 ditëve nga marrja e kësaj vërejtje, t’u paguaj taksën gjyqësore për padi, në shumën prej 50 euro, duke e paralajmëruar paditësin se nëse nuk e paguan taksën gjyqësore për padi, brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se padia është tërhequr konform nenin 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ lidhur me nenin 253 par.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Paditësi vërejtjen e taksës gjyqësore e ka pranuar me datë 03.12.2024, ndërsa edhe pas kalimit afatit konstatohet se paditësi nuk ka vepruar sipas vërejtjes për taksë. Andaj, gjykata konsideron se paditësi është tërhequr nga padia, dhe ka vendosur si në pikën I të këtij aktvendimi, duke e përfunduar procedurën në këtë çështje administrative.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm
KA.nr.1158/22, me datë 29.01.2025

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.